



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 123 prot.

Kamëz, më 16.10.2021

**VENDIM**

Nr. 38 Datë 18/10 /2021

**PËR**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 160 DATË 23.12.2020 "PËR  
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2021, 2022, 2023"**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. **18.10.2021** në kushte të veçanta si pasoje e masave të ndërmara për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.87 dt 11.10.2021

**Në mbështetje të:**

- Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin ..
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Nr. 27 datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023 "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore "
- Shkresa e Ministrisë Financave nr.12705/1 prot dt 19.07.2021 "Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2021 "
- V.K.M Nr.682 dt 29.07.2015 "Per Perdorimin e Fondeve Publike per Transportin e punonjesve Arsimor qe punojne dhe nxenes qe mesojne jashte vendbanimit.
- Shkresa e Zyres Arsimore Kamez nr.923 prot dt 01.10.2021.

**V E N D O S I**

- 1.Miratimin e ndryshimeve të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2021 si me poshtë:
- 2.Miratimin e ndryshimeve në Tabelen e Burimeve të financimit për vitin 2021.
- 3.Miratimin e ndryshimeve të planit të të ardhurave për vitin 2021.
- 4.Miratimin e ndryshimeve të planit të shpenzimeve të funksionimit për vitin 2021.
- 5.Miratimin e ndryshimeve në tabelen e shpenzimeve për investime për vitin 2021.
- 6.Miratimin e ndryshimeve të numrit të punonjesve (shtim punonjes për çerdhe), për vitin 2021, numri i punonjesve që do të shtohet është 53 punonjes dhe do të perballohet nga fondet e planifikuara në fillim të vitit për arsimin parashkollor.
- 7.Miratimin e fondit për transportin e nxënësve të shkolles së mesme Isa Boletini si dhe të një kopshti. (Rindërtim i Shkolles për shkak të termit)
- 8.Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2021 sipas tabelave bashkelidhur.
- 9.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

**ZV.KRYETAR I KESHILLIT**

**ALI DAUTI**

Bashkia Kamez

Bulevardi "Nene Tereza" Nr 492 Kamez, +35547200177, e-mail:bashkiakamez@gmail.com, www.kamez.gov.al